



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TRAJNIMIT, FLETORES SË PUNËS SË KQV-së DHE  
UDHËZUESIT PRAKTIK PËR DETYRAT E ANËTARËVE TË KQV-së,  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE,  
TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 1.6.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për miratimin e Manualit të trajnimit, Fletores së Punës së KQV-së dhe Udhëzuesit Praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019"

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi materialin e paraqitur, si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kompetencës të përcaktuar në nenin 21, pika 9, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr.17/2019 "Për miratimin e strategjisë së trajnimit të komisionerëve zgjedhorë", do të kryejë sesione trajnimi për anëtarët e KQV-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Nr. 750 i Vendimit Data 1.6.2019 e Vendimit Ora 11<sup>00</sup>e Vendimit

Për miratimin e Manualit të Trajnimit, Fletores së Punës së KQV-së dhe Udhëzuesit Praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Manuali trajnimit dhe Fletorja e Punës së KQV-së do të jenë materialet didaktike kryesore që do të përdoren nga anëtarët e KQV-ve në sesionet e trajnimit dhe gjatë ushtrimit të detyrës.

Manuali qartëson veprimtarinë e Komisionit të Qendrës së Votimit nga momenti i emërimit të anëtarëve të KQV-së deri në dorëzimin e materialeve të votimit në KZAZ. Fletorja e Punës është material plotësues i Manualit të trajnimit.

“Udhëzuesi praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së” do të shërbejë si kujtesë për kryerjen në kohën e caktuar të procedurave gjatë ushtrimit të detyrës.

## **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 9, nenin 23, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2009 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë Manualin e trajnimit, Fletoren e Punës së KQV-së dhe Udhëzuesin Praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019”, sipas materialeve bashkëlidhur.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI -</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI -</b>	<b>Anëtare</b>



Nr. 750 i Vendimit Data 1.6.2019 e Vendimit Ora 11<sup>00</sup>e Vendimit

Për miratimin e Manualit të Trajnimit, Fletores së Punës së KQV-së dhe Udhëzuesit Praktik për detyrat e anëtarëve të KQV-së, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019